



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:114781
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06213686

CAP.nr.415/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridiko-civile përmbartimore të kreditorit I.M., të cilën e përfaqëson me autorizim avokati S.K., nga Prishtina, kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore, kërkesë në të holla, duke vendosur sipas ankesës së debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.613/23, të datës 09.01.2024, me datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës/Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktvendimit i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.613/23, i datës 09.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, Cpc.nr.613/23, të datës 09.01.2024, ka vendosur më sa vijon: REFUZOHET i pa bazuar prapësimi i debitorit të përmbartimit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit Cpc.nr.613/23, të datës 30.10.2023, mbi caktimin e përmbartimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e debitorit dhe aktvendimi i atakuar të anulohet si i pa bazë, i pasafatshëm dhe i palejueshëm.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar kreditorja, me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet dhe aktvendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 19.05.2023, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës/Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë, ndërsa gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit e ka caktuar përmbarimin në këtë çështje përmbarimore, në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datën 19/05/2020 si dhe vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1178 i datës 18.11.2020 për korigjimin e gabimeve.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë për caktimin e përmbarimit, debitori ka ushtruar prapësim i cili me aktvendimin e atakuar është refuzuar si i pa bazuar, duke arsyetuar se debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par.1 pika 1 dhe nenit 71 par.1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139).

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar tërësisht si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 e datës 10.02.2020, i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datën 19/05/2020 si dhe vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1178 e datës 18.11.2020 për korigjimin e gabimeve, në bazë të cilit organi përmbarues ka caktuar përmbarimin, është titull

përmbarrimor dhe si i tillë i plotëson kushtet e parapara në nenin 24 paragrafi 3 dhe 5 të LPP-së, dhe mbi këtë bazë ky dokument me të drejtë trajtohet si dokument i përshtatshëm për përmbarrim. Në bazë të nenit 71 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi, e të cilat shkaqe po që ekzistojnë, e pengojnë përmbarrimin e lejuar nga gjykata. Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së përcaktohet se: “Baza për prapsim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapsim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Në këtë rast debitori me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilin do të argumentohet ndonjëri nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së. Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit se kreditori ende pa përfunduar procedura e ankimit ka parashtruar propozim për përmbarrim, për arsye se me nenin 6 paragraf 4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë (Ligji nr. 2002/9), përcaktohet se: “Ankesa e ushtuar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit”. Me nenin 144 paragraf 1, pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Ligji nr. 05/L-031), përcaktohet se: “Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: njoftimin e palës me aktin, kur sipas ligjit ankesa nuk ka efekt pezullues”. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur e ka lejuar përmbarrimin dhe refuzuar prapësimin e debitorit, pasi që në këtë rast përmbarrimi mund të lejohet edhe atëherë kur vendimi i dhënë në procedurë administrative që nuk është bërë përfundimtar vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarrimin, për çka në këtë rast ankesa e paraqitur në procedurë administrative ndaj vendimit të nxjerrë në atë procedurë nuk ka pasur efekt suspensiv gjegjësisht nuk e ka shtyrë ekzekutimin e vendimit ashtu që i njëjti është bërë i ekzekutueshëm nga dita e nxjerrjes së tij, andaj edhe në këtë drejtim mbi bazën e këtij vendimi mund të lejohet përmbarrimi, pasi që ankesa e paraqitur nuk e ka ndaluar ekzekutimin.

Pretendimi ankimor i debitorit që në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res iudicata) dhe se në bazë të të njëjtit vendim-dokument përmbarrimor, gjykata e ka aprovuar prapësimin dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbarrimor, sipas gjykatës ankimore ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që propozimi për përmbarrim është iniciuar sipas dokumentit përmbarrimor pas evitimit të të metave të gjetura në procedurën e mëparshme, do të thotë propozimi është iniciuar pas plotësimit të kushteve ligjore sipas dispozitave të LPP-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarrimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarrimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil

pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.415/24, me datë 25.09.2024

Gjyqtari
Arsim Hamzaj